

## Prof. Dr. Vezir MUHARREMAJ

### EDUKIMI

- **Profesor.** Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Pyjore, 2000
- **Profesor i Asocuar.** Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Pyjore, 1995
- **PHD.** Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Pyjore, 1995
- **Kandidat i Shkencave.** Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Pyjore, 1992
- **MSc.** Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Pyjore, 1964

### EKSPERIENCA

- Ndër kualifikimet e tij më të rëndësishme mund të përmendim trajnime në SHBA, Finlandë dhe Gjermani
- Ai ka një përvojë shumëvjeçare profesionale në mësimdhënie: në vitet 1969-1975 dhe 1989-1995, ka punuar si pedagog i mbarështrimit të pyjeve në Fakultetin e Shkencave Pyjore në Universitetin Bujqësor të Tiranës
- Nga viti 2008 deri në vitin 2012 ka qenë dekan i Fakultetit të Planifikimit dhe Menaxhimit Urban në Universitetin POLIS
- Studimet e kryera në nivel kombëtar përfshijnë: strategjinë kombëtare të zhvillimit të pyjeve dhe kullotave (bashkëautor), analiza e kuadrit ligjor të pyjeve dhe kullotave komunale; planin e përgjithshëm të zhvillimit të pyjeve dhe kullotave në Shqipëri (në kuadër të inventarit Pyjor Kombëtar Shqiptar, bashkëautor), studimin mbi parqet kombëtare, strategjitë për mbrojtjen e natyrës në Shqipëri, studimin mbi shoqatat përdoruese të pyjeve dhe kullotave komunale, mbi vlerësimin e pellgjeve ujëmbledhës të Shqipërisë, mbi kthimin e pyjeve dhe kullotave tek ish pronarët, mbi përcaktimin e moshës optimale të shfrytëzueshmërisë të pyjeve etj
- Në vitet 2004-2008, ka qenë drejtues programi në Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit; në vitet 2001-2003 ka punuar në projektet e USAID (Drejtues Ekipi në Projektin e AWAP); Specialist i Pyjeve të Komunitetit në Projektin APFDP (1996-2000); drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave në Ministrinë e Bujqësisë (1976-1989).
- Ai ka një përvojë pune edhe në sektorin joqeveritar si kryetar i nderuar i Federatës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave Komunale
- Aktualisht, është profesor i Shkencës së Tokës, Planifikimit të Peizazhit (Gjelbërimi Urban) dhe dekan i Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim në Universitetin POLIS



### **FUSHAT E INTERESIT / LENDET**

- Shkenca e Tokes
- Planifikim Peizazhi

### **AKTIVITETE / PUBLIKIME TE ZGJEDHURA**

- Që prej vitit 1971 është autor tekstesh në universitet ("Mbarështrimi i Pyjeve", 1971, 1991 dhe bashkëautor; "Shkenca e Tokës", 2014; "Kudri ligjor për pyjet dhe kullotat komunale", 2009, me bashkautor.
- Ai është autor i dy dispencave dhe disa studimeve dhe eseve kërkimore të botuara në revistat shqiptare dhe ato ndërkombëtare.
- Ka patur pjesëmarrje aktive në një sërë ngjarjesh kombëtare profesionale dhe rreth 20 evenimente ndërkombëtare (kongrese, konferenca dhe seminare) të mbajtura në Ballkan, Europë dhe SHBA, 10 prezantime nga të cilat janë botuar.